


# Ndihmësi për Redaktimin Pamor në Wikipedia

1. Vendos kursorin në tekst dhe fillo shkruani.
2. Shigjeta majtas: Ktheni veprimin. Shigjeta e djathtë: Ripërpuno veprimin.
3. Vendos titullin: vendosni kursorin në një rresht të ri, zgjidhni llojin e titullit që dëshironi të futni (për shembull, titullin ose nëntitullin 1) dhe shkruani emrin e titullit. Shtypni Enter dhe në rreshtin e ardhshme paraqitja e tekstit ndryshon përsëri në Paragraf.

4. Shkronjat e trasha dhe të pjerrëta: së pari zgjidhni tekstin, pastaj zgjidhni formatin që dëshironi të shtoni. Ju mund të zgjidhni stile të tjera të formatimit apo të fshini stilet.
5. Vendosni lidhjet: zgjidhni fjalën në tekst, klikoni mbi këtë simbol dhe menjëherë do të merrni sygjerime. Zgjidhni një të saktë. Nuk ju shfaqet në listë artikulli që ju kërkoni? Shkruani emrin e artikullit që kërkoni dhe pastaj zgjidhni atë.

6. Cito referencat: vendosni kursorin ku doni të vendosni referencën. Kliko butonin dhe shtoni URL, DOI ose ISBN nga burimi. Kliko në 'Prodhoje' dhe më pas 'Vendos'. Me opsionin 'Dorazi' ju mund të shkruani të dhënat tuaja, për shembull për një burim që nuk ka URL, DOI ose ISBN. Me opsionin 'Ripërdoreni' ju mund të përdorni referencat të krijuara më parë.



The screenshot shows the Wikipedia editing interface for the article "Vlera ushqyese". Red circles with numbers 1 through 14 point to specific UI elements: 1. Main navigation menu; 2. Article/Discussion tabs; 3. Undo button; 4. Discussion tab; 5. Paragraph button; 6. Paragraph dropdown menu; 7. Checkmark button; 8. Undo button; 9. Citations button; 10. Help icon; 11. Search bar; 12. Edit button; 13. Search bar; 14. Publish button.

Burimi "Vlera Ushqyese", [https://sq.wikipedia.org/wiki/Vlera\\_ushqyese](https://sq.wikipedia.org/wiki/Vlera_ushqyese) CC BY-SA 3.0

7. Shtoni lista: vendos kursorin në një rresht të ri, zgjidhni 'Listë me toptha' ose 'Listë e numëruar' dhe futni të dhënat. Përfundoni listën duke shtypur Enter në një rresht të zbrazët.
8. Vendosni imazhe: vendosni kursorin në vendin e duhur në tekst, zgjidhni 'Futni' dhe pastaj 'Media'. Shkruani një term kërkimi dhe zgjidhni imazhin e duhur. Shtoni një përshkrim (tregoni se çfarë është imazhi). Kliko 'Fute'.

9. Futni simbole: përdorni këtë buton për të futur simbole dhe karaktere speciale.
10. Ndihma online, shkurtesat dhe përshtypjet.
11. Njoftimi që jeni duke redaktuar pa u kyqur në Wikipedia. IP adresa juaj do të ruhet dhe do të jetë e dukshme për të gjithë.
12. Opsionet si shtimi i kategorive.
13. Kalo tek redaktimi burimor, një mënyrë tjetër për ta redaktuar Wikipedia.

14. Keni përfunduar redaktimin? Kliko tek 'Publiko ndryshimet' (ky buton ka ngjyrën blu). Tregoni shkurtimisht çfarë keni ndryshuar në 'Përmbledhja e redaktimit' (për shembull "përmisimi i gabimeve drejtshkrimore"). Kliko 'Shqyrtoni ndryshimet tuaja' për të parë atë që keni ndryshuar. Jeni të kënaqur? Kliko në 'Publiko ndryshimet' dhe veprimet e juaja do të ruhen. Urime! Ju ndihmuat në përmisimin e Wikipedia-s!